



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe në nenin 8, paragrafi 8.1, 8.2 dhe 8.5 të Ligjit Nr.2004/21 për Veterinarinë të datës 30.07.2004, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr sa vijon:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 32/2008
Për parandalimin, kontrollin, luftimin dhe eradikimin e sëmundjes së
Salmonelozës tek shpezët

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim administrativ rregullon ruajtjen e shëndetit të kafshëve për të cilën çështje Autoriteti Kompetent përcakton masat veterinare të cilat do të zbatohen në shpeztari në të gjitha fermat komerciale në territorin e Republikës së Kosovës - me qëllim të parandalimit dhe luftimit të përhapjes së sëmundjes zoonotike Salmoneloza.

Neni 2
Përkufizimet

Për kuptimin e këtij udhëzimi administrativ, termat e përdorur kanë këtë domethënie:
“**Salmoneloza**” - është sëmundje bakteriale e shpezëve e shkaktuar nga bakteret e gjinise Salmonela spp. prej të cilave veçohen: Salmonela enteritidis, Salmonela typhimurium, Salmonela gallinarum dhe Salmonela pulorum;
“**Hulumtimet diagnostike**” - janë hulumtime të cilat behën përmes analizave tek shpezët për diagnostikimin e sëmundjes së Salmonelozës;
“**Zoonoza**”- është infeksioni apo sëmundja qe bartet nga kafshët tek njeriu;
“**Agjent zoonotik**”- është bakteri i cili e shkakton zoonozën;
“**Laborator veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës**” - është organ kompetent dhe i autorizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për kryerjen e analizave laboratorike dhe diagnostikimin e sëmundjeve të kafshëve, ushqimit të kafshëve dhe mbetjeve të barnave veterinare;

“Mostra zyrtare” - është mostër e marr nga Autoriteti Kompetent për t’u analizuar agjenti zoonotik. Mostra duhet të jetë e shoqëruar me informacionin për llojin, sasinë dhe metodën e marrjes së mostrës, identifikimin për origjinën e shpendit apo produktit të tij;
“Mostra” - është një sasi materiali të cilën e merr personi përgjegjës për shpeztarinë në fermë, veterinar i autorizuar apo inspektori veterinar, e cila do të dërgohet në Laborator për verifikimin e pranisë së agjentit zoonotik;
“Autoriteti Kompetent” - është Agjencioni Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës;
”Inspektori veterinar” është zyrtari i Autoritetit Kompetent.

Neni 3

Të infektuara nga sëmundja Salmoneloz konsiderohen shpezët të cilat me anën e kontrollës bakteriologjike – mikroskopike, mbjelljen e kulturës, kontrollet serologjike, biokimike ose molekular-biologjike rezultojnë pozitive në bakteret e gjinisë Salmonela spp.

Neni 4

Kontrolli i sëmundjes së Salmonelozës

1. Objekt i kontrollës diagnostike në Salmonelozë janë:
 - 1.1 lëndët e para me prejardhje animale për përgatitjen e ushqimit i cili përdoret për ushqimin e shpezëve - miell peshku, miell i eshtrave, miell gjaku, miell i përgatitur nga mbeturinat e therjes së shpezëve etj;
 - 1.2 ushqimi i cili është përdorur për ushqimin e shpezëve të prekura nga sëmundja e Salmonelozës,
 - 1.3 pajisjet dhe hapësirat për inkubimin e vezëve;
 - 1.4 vezët e fekunduara - prej të cilave nuk ka pasur çelje të zogjve, kufomat e zogjve të çelur dhe fecesi i tyre;
 - 1.5 zogjtë një ditë të ngordhur gjatë transportit dhe zogjtë të cilët ngordhin 3 ditë pas transportit;
 - 1.6 fermat për rritje, pulat vojse dhe prodhim mishi;
 - 1.7 kufomat e shpezëve të ngordhura prej fermave prindërore dhe fermave prodhuese;
 - 1.8 lëkura, mishi dhe organet parenhimatoze - mëlçia, zemra, bursa e fabricit, shpretka të shpezëve të therura.

Neni 5

Numri i mostrave që do të merren

1. Autoriteti kompetent planifikon hulumtimet diagnostike për sëmundjen e Salmonelozës dhe zbaton parametrat e marrjes së mostrave në fermat komerciale siç vijon:

1.1 Në ferma deri 1000 shpezë	merren	30	mostra të gjakut
1.2 Në ferma prej 1001-5.000 shpezë	merren	60	mostra të gjakut
1.3 Në ferma prej 5001-10.000 shpezë	merren	100	mostra të gjakut
1.4 Në ferma prej 10.001-20.000 shpezë	merren	140	mostra të gjakut
1.5 Në ferma Mbi 20.000 shpezë	merren	180	mostra të gjakut

Neni 6 **Marrja e mostrave**

1. Në zogjtë 24 orësh merren mostrat nga hapësira e brendshme e kutive të transportimit të tyre për në fermë si dhe karkasa të zogjve që janë gjetur të ngordhur kur kanë mbërritur në fermë.
2. Në zogëzat 4 javësh dhe me moshë 2 javë para se të futën në fazën e prodhimit të vezëve, merren mostrat nga fekalet e freskëta me peshë jo më pak se 1 gr. Mostrat mund të merren edhe në vende ku më parë janë mbajtur ose kanë lëvizur zogjtë.
3. Numri i vendeve nga të cilat duhet të merren mostrat e veçanta me qëllim që të krijohet një mostër e përbashkët duhet të jete si në vijim:

Nr. i zogjve të mbajtur në një ndërtesë	Nr. i mostrave të fekaleve që duhen marrë në një ndërtesë apo grup ndërtesash të një ferme
1-24	Nr. i njëjtë me nr. e zogjve maksimumi deri në 20 zogje
25-29	20
30-39	25
40-49	30
50-59	35
60-89	40
90-199	50
200-499	55
500 ose më tepër	60

Neni 7 **Kontrolli i Salmonelozes**

1. Kontrolli i Salmonelozës në tufat prindërore bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën 1 bashkëngjitur të këtij udhëzimi administrativ.
2. Kontrolli i Salmonelozës në inkubator do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën 2 bashkëngjitur të këtij udhëzimi administrativ.
3. Kontrolli i Salmonelozës të shpezët e rritura për prodhimin e vezëve për konsum do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën 3 bashkëngjitur të këtij udhëzimi administrativ.
4. Kontrolli i Salmonelozës të shpendët për majmëri do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në tabelën 4 bashkëngjitur të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 8 **Masat veterinare - sanitare në tufat e infektuara**

1. Në rast se tek shpezët e një ferme është konfirmuar prania e Salmonelozes, merren masat si në vijim:
 - 1.1 lënda e parë për përgatitjen e ushqimit të shpezëve, duhet të dekontaminohet;
 - 1.2 hapësirat, aparatet dhe pajisjet në vendin e deponimit dhe ruajtjes së ushqimit të shpezëve, duhet të trajtohen me dezinfektant adekuat;

- 1.3 hapësirat, pajisjet dhe ambalazhi në stacionet e inkubimit dhe mjetet e transportit të shpezëve duhet të trajtohen me metodat adekuate dhe të dezinfektohen;
 - 1.4 vezët për çelje, menjëherë mblidhen dhe aparatura për çelje, duhet të dezinfektohen me gasin baktericid;
 - 1.5 zogjtë e çelur, deri sa janë të lagur, duhet të trajtohen me gasin baktericid;
 - 1.6 vezët e paçelura, dhe zogjtë e dobët dhe mbeturinat tjera nga inkubatori duhet të asgjësohen;
 - 1.7 dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve të infektuara për majmëri të shpezëve, për prodhim të mishit dhe të vezëve;
 - 1.8 largimi i plehrave, paketimi dhe moslejimi i përdorimit deri sa të kalojnë tre muaj prej ditës së paketimit.
2. Në rastet kur bëhet mjekimi i shpezëve të infektuara me antibiotik në bazë të antibiogramit, asnjë shpezë nuk lejohet të dalë nga ndërtesa e fermës - me përjashtim të rasteve kur Autoriteti Kompetent ka urdhëruar therjen e tyre në një thertore tjetër.
 3. Vezët e painkubuara, të prodhuara nga pulat e tufës ame që mbarështohen në ndërtesën e fermës ku është vërtetua salmonelozja, duhet të eliminohen dhe shkatërrohen.
 4. Konsiderohet se rreziku nga sëmundja e Salmonelozës tek shpezët ka kaluar kur me anën e hulumtimit diagnostik të kryer ditën e pestë dhe ditën e dhjetë pasi janë marrë të gjitha masat e parapara dhe pas mjekimit, konstatohet rezultati negativ në organet e shpezëve të ngordhura dhe tek shpezët e dërguara në therje të dhunshme.
 5. Shpezët mund të ushqehen vetëm me ushqim të cilit ju kanë bërë analizat laboratorike dhe të rezultuar negativ për praninë e sëmundjes së Salmonelozës.

Neni 9

1. Pas zbrazjes nga tufat e infektuara nga Salmonela enteriditis ose Salmonela tiphymurium, hapësira, duhet të pastrohet, dezinfektohet, ndërsa fekalet - plehu grumbullohet në një vend të sigurt sipas udhëzimeve, procedurave të përcaktuara nga Autoriteti Kompetent.
2. Futja e tufave të reja, duhet të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kompetent.
3. Kur në dhomën e inkubimit janë ende të pranishme vezët për inkubim të marra nga tufa në të cilat është vërtetuar prania e Salmonela enteriditis apo Salmonela tiphymurium, këto vezë, duhet të konfiskohen, të shkatërrohen dhe eliminohen, duke u trajtuar si material me rrezikshmëri të lartë sipas Direktivës 90/667/BE.

Neni 10

Inspektimi për Salmonela spp. në fazën përfundimtare të prodhimit të ushqimit për shpezë

1. Në fabrika të prodhimit të ushqimeve për shpezë, mund të merren mostrat nga këto ushqime në rast dyshimi për Salmonelozë. Mostrat për analizë të ushqimeve për shpezë duhet të merren edhe në fazën përfundimtare të prodhimit të tyre më së paku një herë në muaj.
2. Kur një mostër ushqimi për shpezët në fazën përfundimtare të prodhimit të tij del pozitiv në Salmonelozë, Autoriteti Kompetent bënë hetim për të:

- 1.1 identifikuar burimin e kontaminimit, duke marrë kampione zyrtare në fazat e ndryshme të prodhimit të ushqimeve për shpezë;
- 1.2 ekzaminuar zbatimin e rregullave dhe kontrolluar përpunimin e mbeturinave të kafshëve dhe shpendëve, në veçanti ato të përcaktuara me Direktivën 90/667/BE;
- 1.3 vendosë procedura për praktikën e prodhimit të mirë si dhe të siguruar përputhjen me procedurat që kanë ekzistuar më parë.

Neni 11

Pjesë përbërëse të këtij udhëzimi administrativ janë shtojcat me tabela 1.2.3 dhe 4 të cilat përcaktojnë marrjen e mostrave në fermat e shpezëve.

Neni 12 Zbatimi

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, Kryeshefi Ekzekutiv i Autoritetit kompetent mund të nxjerr vendime të posaçme.
2. Moszbatimi i këtij udhëzimi administrativ do të sanksionohet sipas nenit 45 të Ligjit për Veterinarinë dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë _____ 2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri
Idriz Vehapi

TABELA 1

SHPEZËT NË RRRITJE PËR PRODHIMIN E VEZËVE PËR ÇELJE

KATEGORIA DHE MOSHA E SHPENDËVE	VENDI I MARRJËS SË MOSTRAVE	MOSTRA	NR. I MOSTRAVE		FREKUENCA E MARJES SË MOSTRAVE
ZOGJTË NJË DITOR	OBJEKTI PËR RRRITJE	ZOGJTË E NGORDHUR MBAS 3 DITESH	10 KUTIJA TE TRASPORTIT DHE KREJTE ZOGJTE E NGORDHUR		MENJEHERË PAS DËRGIMIT
1-3 JAVË	OBJEKTI PËR RRRITJE	ZOGJTE E NGORDHUR	ME SE PAKU 10 ZOGJE TE NGORDHUR		1X
8 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA SE BASHKU ME FECES	5 MOSTRA *		1X
12 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA SE BASHKU ME FECES	5 MOSTRA *		1X
16 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA SE BASHKU ME FECES	5 MOSTRA *		1X
21 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA SE BASHKU ME FECES	5 MOSTRA *		1X
PAS PRODHIMIT TE VEZEVE	OBJEKTI PER RRRITJE	GJAK	MADHESIA E TUFES	NR I MOSTRAVE	1 HERE TEK PRODHIMTARIA 15%
			DERI 120	NUMRI I NJETJE I SHPEZEVE NE TUFE	2 HERE TEK MOSHA 42-46 JAVESHE
			MBI 120	120	
		MOSTER E PERBASHKET FECESI	5 MOSTRA *		1 X NE MUAJ
		SHPENDET E NGORDHUR	ME SE PAKU 3		1 X NE MUAJ

*** (1 MOSTER KONSIDEROHET 12 FECESE TË FRESKËTA)**

TABELA 2

PRODHIM NË INKUBATOR

KATEGORIA DHE MOSHA E SHPENDËVE	VENDI I MARRJËS SË MOSTRAVE	MOSTRA	NR. I MOSTRAVE	FREKUENCA E MARJES SË MOSTRAVE
INKUBATORI ME KAPACITET ME PAK SE 1000 VENDMBAJTESE TE VEZEVE	INKUBATOR	ZOGU I PAQELUR OSE ZOGU NJE DITOR	1 MOSTER	NJE HERE NE CDO TUFE TE SJELLURA NE INKUBATOR
INKUBATORI ME KAPACITET MBI 1000 VEZE PER INKUBIM	INKUBATOR	ZOG I PAQELUR OSE ZOG NJE DITOR	2 MOSTRA	NJE HERE NE CDO TUFE TE SJELLUR NE INKUBATOR

***(1 MOSTËR KONSIDEROHET 30 ZOGJE TË PACELUR OSE ZOGJE NJËDITOR)**

TABELA 3

SHPEZËT NË RRRITJE PËR PRODHIMIN E VEZËVE PËR KONSUM

KATEGORIA DHE MOSHA E SHPENDËVE	VENDI I MARRJËS SE MOSTRAVE	MOSTRA	NR. I MOSTRAVE		FREKUENCA E MARJËS SË MOSTRAVE
ZOGJTE NJË DITOR DERI NE 72 ORE	OBJEKTI PËR RRRITJE	KUTIA E TRASPORTIT OSE ZOGJTE E NGORDHUR MBRENDIA 3 DITESH	10 KUTIJA TE TRASPORTIT DHE KREJTE ZOGJTE E NGORDHUR		MENJEHERE PAS DERGIMIT
MOSTRA 3 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA TE PERGJITHSHME DHE FECESI	5 MOSTRA *		1X
8 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA SE BASHKU ME FECES	5 MOSTRA *		1X
14 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	MOSTRA SE BASHKU ME FECES	5 MOSTRA*		1X
MOSHA 25 JAVESHE	OBJEKTI PER RRRITJE	VE (1MOSTER 10 VEZE PER KONSUM NE GEZHOJA)	MADHESIA E TUFES (COP)	NR I MOSTRAVE	1 HERE TEK PRODHIMTARIA
			DERI 500	3	
			501-5000	6	
			5001-10000	9	
			MBI 10000	12	
		MOSTRA E PERBASHKET FECES	5 MOSTRA *		1 X NE MUAJ
		SHPENDET E NGORDHUR	ME SE PAKU 3		1 X NE MUAJ

*** (1 MOSTER KONSIDEROHET 12 FECESE TË FRESKETA)**

TABELA 4
SHPEZËT PËR MAJMËRI

KATEGORIA DHE MOSHA E SHPENDËVE	VENDI I MARRJËS SË MOSTRAVE	MOSTRA	MADHËSIA A TUFES	NR. I MOSTRAVE	FREKUENCA E MARJES SË MOSTRAVE
ZOGJTE NJE DITOR DERI NE 72 ORE	OBJEKTI PER RRITJE	KUTIA E TRANSPORTIT OSE ZOGJTE E NGORDHUR MBRENDIA 3 DITESH	DERI NE 500	10 SHTRESA TE PAKOVE TE TRANSPORTIT DHE ZOGJTE E NGORDHUR	MENJEHERE PAS DERGIMIT
			501-5000	10 SHTRESA TE PAKOVE TE TRANSPORTIT DHE ZOGJTE E NGORDHUR	
			5001-12.000	10 SHTRESA TE PAKOVE TE TRANSPORTIT DHE 30% TE ZOGJEVE TE NGORDHUR	
			MBI 12.000	10 SHTRESA TE PAKOVE TE TRANSPORTIT DHE 30% TE ZOGJEVE TE NGORDHUR	
SHPENDET PER MAJMËRI	OBJEKTI PER RRITJE	MOSTRA E FECESI TE PERBASHKETA	DERI NE 500	1	DERI NE 14 DITE PARA THERJES
			501-5000	3	
			5001-12.000	4	
			MBI 12.000	5	

*** (1 MOSTER KONSIDEROHET 12 FECESE TË FRESKËTA)**